



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1166/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Bardhyl Topalli, kandidat për anëtar të kuvendit komunal nga radhët e AKR-së në Ferizaj, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të manipulimit me vota, për Zgjedhjet Lokale në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Bardhyl Topalli kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Ferizaj nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 03.12.2013 në ora 14:45 nga Bardhyl Topalli ku ka pretenduar se në:

Qendrat e Votimi nr: 2501Y/11R Ahmet Hoxha, QVnr: 2502D/04R Shaban Hashani, QV nr: 2503D/04R Faik Konica, QV nr: 2507D/01R/05R f.sh Greme, QV nr: 2508/01R/02R/03 f.sh Gaqkë, QV nr: 2510/01R, f.sh Komogllavë, QV nr: 2511/01R/02R, f.sh Sojevë, QV nr: 215/01R, f.sh Mirash, QV nr: 2524/01R, f.sh Surqinë, QV nr: 2526/01R f.sh Softaj, QVnr: 2526/01R f.sh Softaj, QV nr: 2528/01R/02R f.sh Bibaj, QV nr: 2526/01R f.sh Zllatar. Pretendohet se është manipuluar me votat e tij pasi që votat e votuesve të tij nuk figurojnë, thuhet në ankesë. Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi nga shkresat e lëndës se pretendimet ankimore të kandidatit për anëtar të kuvendit komunal Bardhyl Topalli janë të pa argumentuara në fakte dhe dëshmi konkrete pasi që ankesës në fjalë nuk i ka bashkangjitur asnjë dëshmi bindëse, për tu vërtetuar për shkeljen e supozuar andaj ankesa vlerësohet si e pa bazë, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 1166/2013 më datën 06.12.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani**



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.